



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 14, datë 23.3.2023

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË DHE MBIKËQYRJEN E INSTITUCIONEVE TË PAGESAVE”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “b”, nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të neneve 10, 11, 12, 18, 19, 24 dhe 25 të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020 “Për shërbimet e pagesave”; me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për ushtrimin e veprimtarisë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pagesave”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen institucionet e pagesave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SEKRETARI

KRYETARI

Elvis ÇIBUKU

Gent SEJKO

KREU I TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve të pagesave dhe për administrimin e rreziqeve që lidhen me këtë veprimtari, si dhe për mbikëqyrjen e tyre.

Neni 2 Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë institucionet e pagesave, siç përcaktohen në pikën 13 të nenit 5 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”.

Neni 3 Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “b”, nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të neneve 10, 11, 12, 18, 19, 24 dhe 25 të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020 “Për shërbimet e pagesave” (i cili, në këtë rregullore, do të quhet ligji “Për shërbimet e pagesave”).

Neni 4 Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në ligjin “Për shërbimet e pagesave”. Për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termi i mëposhtëm ka këtë kuptim:
 - a) “sistemi i kontrollit të brendshëm” - përfshin procesin e monitorimit dhe të vlerësimit të vazhdueshëm të mjaftueshmërisë dhe efektivitetit të akteve të brendshme dhe mekanizmave të kontrollit brenda një institucioni dhe të cilësisë së operacioneve të veprimtarisë së tij, të kryera nga strukturat përgjegjëse, për realizimin e funksioneve të sistemit të kontrollit të brendshëm.

KREU II KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT DHE MBIKËQYRJEN GJATË USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONEVE TË PAGESAVE

Neni 5 Kërkesa të përgjithshme prudenciale

1. Institucionet e pagesave duhet të kenë procedura administrimi, kontabiliteti dhe sisteme të mjaftueshme të kontrollit të brendshëm, mbi baza individuale e të konsoliduara, në përputhje me këtë rregullore.

2. Institucionet e pagesave nuk pranojnë depozita monetare ose fonde të tjera të ripagueshme nga publiku, sipas kuptimit të nenit 4 të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.
3. Fondet e marra nga institucionet e pagesave prej përdoruesve të shërbimeve të pagesave, me qëllim ofrimin e shërbimeve të pagesave nuk konsiderohen depozita monetare ose fonde të tjera të ripagueshme dhe as para elektronike, sipas kuptimit të nenit 4 të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 6

Veprimtaritë e tjera

Institucionet e pagesave, përveç ofrimit të shërbimeve të pagesave të listuara në aneksin 1 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, mund të kryejnë një ose disa nga veprimtaritë e parashikuara në nenin 19 të atij ligji.

KREU III

PARIMET DHE RREGULLAT BAZË TË DREJTIMIT TË PËRGJEGJSHËM DHE EFEKTIV DHE SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Neni 7

Kërkesa të përgjithshme

Institucionet e pagesave krijojnë rregulla, procedura dhe sisteme të kontrollit të brendshëm lidhur me drejtimin e përgjegjshëm dhe efektiv, të cilët duhet të jenë gjithëpërfshirës e proporcionalë me natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e aktivitetit dhe shërbimeve të ofruara nga institucionet e pagesave.

Neni 8

Kultura e përgjithshme e drejtimit

1. Organet drejtuese të institucionit të pagesave, në zbatimin e detyrave dhe përgjegjësi që lidhen me drejtimin dhe kontrollin e institucionit të pagesave, njohin në mënyrë të plotë dhe të qartë profilin e rrezikut të këtij institucioni, duke përcaktuar e miratuar paraprakisht ndërmarrjen dhe tolerancën ndaj rrezikut, si dhe ndjekjen në vazhdimësi të tij në përputhshmëri me këto të fundit, duke siguruar që nivelet e kapitalit të mbulojnë mjaftueshëm këtë rrezik.
2. Organet drejtuese të institucionit të pagesave, nëpërmjet mënyrës së drejtimit, nxisin (stimulojnë) një kulturë të përshtatshme drejtimi, të bazuar në standarde të larta profesionale dhe vlera të larta etike.
3. Organet drejtuese të institucionit të pagesave marrin masa për arritjen e standardeve të larta etike dhe profesionale në drejtimin e institucionit të pagesave.

Neni 9

Sistemi i administrimit të rrezikut

1. Institucionet e pagesave krijojnë dhe zhvillojnë sistemin e administrimit të rrezikut, lidhur me ofrimin e shërbimeve të pagesave, në përputhje me natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e veprimtarisë së tyre. Rreziqet që lidhen me veprimtarinë e shërbimeve të pagesave, mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- a) rrezikun e shlyerjes (rreziku që shlyerja e një transaksioni pagese të mos kryhet sipas parashikimeve);
 - b) rrezikun operacional (rreziku që subjekti të pësojë humbje financiare si rezultat i papërshtatshmërisë ose dështimit të proceseve të brendshme dhe të sistemeve, gabimeve njerëzore, ose i ngjarjeve të jashtme);
 - c) rrezikun e kundërpartisë (rreziku që pala tjetër e përfshirë në transaksion të mos përmbushë detyrimet);
 - d) rrezikun e likuiditetit (rreziku që institucioni i pagesave të ketë flukse të pamjaftueshme monetare për të përmbushur detyrimet financiare);
 - e) rrezikun e tregut (rreziku që shkaktohet nga luhatjet në çmimet e tregut);
 - f) rrezikun e pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit (rreziku që institucioni i pagesave ose shërbimet që ofron, të përdoren për qëllime që lidhen me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit);
 - g) rrezikun e kursit të këmbimit (rreziku që shkaktohet nga luhatjet në kursin e këmbimit).
2. Sistemi i administrimit të rrezikut është tërësia e politikave, procedurave, rregullave dhe strukturave të institucioneve të pagesave, që shërbejnë për administrimin e rrezikut.
 3. Sistemi i administrimit të rrezikut përfshin:
 - a) procesin e identifikimit, matjes, monitorimit, kontrollit dhe raportimit, të të gjitha rreziqeve brenda institucionit të pagesave, në të gjithë aktivitetin e tij (për të gjithë bilancin, linjat e biznesit, agjentët, etj.);
 - b) përcaktimin e funksioneve të strukturave të administrimit të rrezikut, të cilat sigurojnë:
 - i. identifikimin e të gjitha rreziqeve,
 - ii. vlerësimin e rreziqeve dhe matjen e ekspozimit ndaj tyre,
 - iii. monitorimin e ekspozimit të rrezikut dhe përcaktimin e nevojave për kapital në mënyrë të vazhdueshme,
 - iv. monitorimin dhe vlerësimin e vendimeve për pranimin e rreziqeve të caktuara, masat për zbutjen e rrezikut dhe nëse vendimet janë në përputhje me vendimet e organeve drejtuese për politikën e rrezikut,
 - v. raportimin, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të pavarur, në organet drejtuese, të të gjitha çështjeve të përcaktuara më lart.

Neni 10

Funksioni/njësia e kontrollit të brendshëm

1. Institucionet e pagesave krijojnë funksionin/njësinë e kontrollit të brendshëm, si pjesë të sistemit të kontrollit të brendshëm.
2. Funksioni/njësia e kontrollit të brendshëm është njësi organizative e veçantë e subjektit, e pavarur nga veprimtaritë, strukturat dhe personat që ajo shqyrton ose kontrollon, e cila raporton përpara këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe/ose komitetit të kontrollit të subjektit.
3. Funksioni/njësia e kontrollit të brendshëm siguron, në mënyrë të pavarur, organet drejtuese mbi cilësinë dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit, si dhe mbi sistemin dhe proceset e drejtimit/qeverisjes dhe të administrimit të rreziqeve.
4. Funksioni/njësia e kontrollit të brendshëm zbaton standardet ndërkombëtare të kontrollit të brendshëm.

5. Institucionet e pagesave hartojnë dhe miratojnë akte të brendshme për funksionimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së këtij funksioni/kësaj njësie, të cilat hartohen dhe rishikohen sa herë gjykohet e nevojshme.
6. Aktet e brendshme që përcaktojnë mënyrën e funksionimit dhe të ushtrimit të veprimtarisë së funksionit/njesisë së kontrollit të brendshëm, përmbajnë minimalisht elementet e mëposhtme:
 - a) qëllimin dhe fushën e veprimit të funksionit/njesisë së kontrollit të brendshëm;
 - b) rolin, autoritetin dhe përgjegjësitë e funksionit/njesisë së kontrollit të brendshëm;
 - c) marrëdhëniet e funksionit/njesisë së kontrollit të brendshëm me funksione të tjera të sistemit të kontrollit brenda subjektit;
 - d) mënyrat dhe linjat e komunikimit të rezultateve të veprimtarisë së kontrollit;
 - e) procedurat për koordinimin me audituesin ligjor ose shoqërinë e auditimit, si dhe me autoritetin mbikëqyrës;
 - f) të drejtën për të përdorur në mënyrë të plotë dhe të pakushtëzuar çdo regjistrim, dosje, bazë të dhënash, aktive fizike të institucionit të pagesave, si edhe çdo dokumentacion të organeve drejtuese apo njësive organizative, të nevojshme për kryerjen e funksioneve;
 - g) të drejtën e drejtuesit të funksionit/njesisë së kontrollit të brendshëm për të pasur kontakt të drejtpërdrejtë me organet drejtuese;
 - h) të drejtën e planifikimit dhe përcaktimit të kontroleve në mënyrë të pavarur;
 - i) sigurimin e shmangies së çdo konflikti interesash në kryerjen e detyrave të kontrollit të brendshëm;
 - j) kërkesa për përputhshmërinë me standardet më të mira të kontrollit të brendshëm.
7. Frekuenca e kontrollit bazohet në vlerësimin e çdo fushe veprimtarie dhe shërbimi, si dhe njësie organizative të institucionit të pagesave, të bazuar në rrezik. Të gjitha fushat e veprimtarisë dhe shërbimeve dhe njësitë organizative të institucionit të pagesave janë objekt kontrolli nga funksioni/njësia e kontrollit të brendshëm, të paktën çdo tre vjet, përfshirë edhe ato fusha veprimtarie dhe shërbimi dhe njësi organizative me rrezik të ulët, si dhe degët, agjentët dhe palët e treta të kontraktuara.
8. Funksioni/njësia e kontrollit të brendshëm përgatit një raport për çdo kontroll të kryer, i cili përmban të paktën:
 - a) objektin e kontrollit;
 - b) përshkrimin e punës së kontrollit (përshkrimin e metodologjisë, hapat dhe procedurat e ndjekura për të arritur objektivat e kontrollit, etj.);
 - c) gjetjet e kontrollit;
 - d) komentet e drejtuesve përgjegjës të njesisë organizative të kontrolluar, për gjetjet e kontrollit;
 - e) vlerësime për kualifikimin e personelit, mjaftueshmërinë e akteve të brendshme dhe sistemet e vlerësimit të rrezikut, sipas rasteve përkatëse;
 - f) rekomandime për korrigjimin dhe përmirësimet e gjetjeve, të vërejtura gjatë aktit të kontrollit; si dhe
 - g) nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga kontrollet e mëparshme.
9. Punonjësit e funksionit/njesisë së kontrollit të brendshëm kanë:
 - a) reputacion të lartë etik dhe profesional;
 - b) aftësi profesionale në zbatimin e standardeve ndërkombëtare të kontrollit të brendshëm, të procedurave dhe teknikave të kontrollit në të gjitha fushat e aktivitetit të institucionit të pagesave;

- c) njohje dhe/ose përvojë në zbatimin e standardeve të kontabilitetit;
 - d) njohje të parimeve të administrimit të rrezikut.
10. Në fund të çdo viti, funksioni/njësia e kontrollit të brendshëm përgatit planin e punës për vitin e ardhshëm, i cili paraqitet për miratim në organet drejtuese të institucionit të pagesave.
11. Funksioni/njësia e kontrollit të brendshëm paraqet një raport vjetor mbi punën e tij/saj tek organet drejtuese të institucionit të pagesave, i cili përmban elementet e mëposhtme:
- a) një raport mbi nivelin e zbatimit të planit vjetor të punës së funksionit/njesisë së kontrollit të brendshëm;
 - b) një listë të të gjitha aktiviteteve të planifikuara dhe të realizuara nga funksioni/njësia e kontrollit të brendshëm;
 - c) një listë të të gjitha aktiviteteve të realizuara, por të paplanifikuara në planin vjetor të punës së funksionit/njesisë së kontrollit të brendshëm;
 - d) një listë të të gjitha aktiviteteve të planifikuara, por të parealizuara nga funksioni/njësia e kontrollit të brendshëm, shoqëruar me arsyet e mosrealizimit;
 - e) një përmbledhje të gjetjeve më të rëndësishme të identifikuar gjatë kontrolleve;
 - f) një vlerësim të përgjithshëm të mjaftueshmërisë dhe eficiencës së sistemit të kontrollit të brendshëm, në fushat e mbuluara nga funksioni/njësia e kontrollit të brendshëm;
 - g) një vlerësim të përgjithshëm të mjaftueshmërisë dhe eficiencës së sistemit të administrimit të rrezikut;
 - h) një raport mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve dhe masave korrektuese të përcaktuara në bazë të rekomandimeve, si dhe arsyet e moszbatimit të tyre.

Neni 11

Funksioni i përputhshmërisë

1. Institucionet e pagesave duhet të kenë një drejtues ekzekutiv, që kryen funksionin e identifikimit, koordinimit dhe të administrimit të rrezikut të përputhshmërisë.
2. Struktura/njësia e përputhshmërisë është e pavarur nga linjat e biznesit dhe nga njësitë e brendshme që kontrollojnë dhe ka autoritetin, reputacionin dhe burimet e mjaftueshme.
3. Përgjegjësia kryesore e strukturës/njesisë, që përmbush funksionin e përputhshmërisë të subjektit është të asistojë organet drejtuese të institucionit të pagesave, në administrimin efektiv të rrezikut të përputhshmërisë.
4. Struktura/njësia e përputhshmërisë këshillon organet drejtuese të institucionit të pagesave, lidhur me përputhshmërinë me ligjet, rregullat dhe standardet, duke i informuar ato në vazhdimësi, mbi zhvillimet në këtë fushë, si dhe në veçanti kryen detyrat e mëposhtme:
 - a) edukimin dhe trajnimin e personelit për çështjet e përputhshmërisë, duke shërbyer edhe si pikë kontakti brenda subjektit për çështje apo pyetje të personelit lidhur me përputhshmërinë;
 - b) hartimin e udhëzimeve të brendshme për zbatimin e ligjeve, të rregulloreve dhe të standardeve, nëpërmjet politikave dhe procedurave apo dokumenteve të tjera, si manualët e përputhshmërisë, kodet e brendshme të etikës dhe udhëzimet praktike;
 - c) identifikimin, dokumentimin dhe vlerësimin e rreziqeve të përputhshmërisë në veprimtarinë e institucionit të pagesave, duke përfshirë produktet dhe praktikën e reja, tipet e linjave të reja të propozuara të veprimtarisë ose të marrëdhënieve me klientët dhe ndryshimet e rëndësishme në këto marrëdhënie;
 - d) vlerësimin e ndikimit të mundshëm të çdo ndryshimi ligjor dhe rregullativ në veprimtarinë e institucionit të pagesave dhe në kuadrin e përputhshmërisë;

- e) matjen e rrezikut të përputhshmërisë duke përdorur treguesit e performancës (të tillë si rritja e numrit të ankesave të klientëve, parregullsitë në pagesa, etj.), me qëllim vlerësimin e këtij rreziku;
 - f) vlerësimin e përshtatshmërisë së procedurave dhe rregulloreve të përputhshmërisë, si dhe vlerësimin e mangësive të identifikuara, duke mundësuar edhe propozime për amendime;
 - g) monitorimin, testimin dhe raportimin e rezultateve nga testimi i mjaftueshmërisë së përputhshmërisë, sipas procedurave të sistemit të brendshëm të administrimit të rrezikut, duke evidentuar edhe ndryshimet në profilin e rrezikut të përputhshmërisë, mbështetur në treguesit e performancës, shkeljeve dhe/ose mangësive të identifikuara dhe të masave korrigjuese të ndërmarra;
 - h) krijimin e një kulture inkurajuese dhe të përshtatshme për sinjalizimin nga ana e punonjësve të institucionit të pagesave, të mospërputhshmërisë me rregullat, procedurat, operacionet etj., duke siguruar njëkohësisht konfidencialitetin dhe mbrojtjen e këtyre të fundit (punonjësve).
5. Struktura/njësia e përputhshmërisë mund të kryejë dhe detyra të tjera të veçanta, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore të subjektit (të tilla si, ato të parandalimit të pastrimit të parave, etj.), si dhe mban lidhje me Bankën e Shqipërisë dhe/ose autoritete të tjera të mbikëqyrjes së veprimtarisë financiare, audituesin ligjor ose shoqërinë e auditimit, etj.
 6. Struktura/njësia e përputhshmërisë kryen detyrat e përcaktuara në këtë rregullore dhe në aktet rregullative të institucionit të pagesave, mbështetur në një program pune, që përcakton aktivitetet e planifikuara, të tilla si zbatimi dhe rishikimi i politikave, procedurave të veçanta të rrezikut të përputhshmërisë, vlerësimet, testet e përputhshmërisë dhe edukimin e trajnimit të personelit për çështje të përputhshmërisë.
 7. Programi i strukturës/njesisë së përputhshmërisë duhet të jetë i bazuar tek rreziku dhe duhet të rishikohet në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim që të sigurohet që ky program mbulon të gjitha linjat e biznesit/veprimtarisë së institucionit të pagesave dhe siguron koordinimin midis funksioneve të administrimit të rrezikut.

KREU IV

KËRKESAT PËR KAPITAL, MBROJTJA E FONDEVE DHE ADMINISTRIMI I RREZIQEVE

NËNKREU I

MJAFTUESHMËRIA E KAPITALIT

Neni 12

Kërkesa të përgjithshme për kapitalin e institucionit të pagesave

1. Institucioni i pagesave siguron nivele të mjaftueshme të kapitalit, për ushtrimin e veprimtarisë të sigurt dhe të qëndrueshme, si dhe për përmbushjen e detyrimeve të tij gjatë ushtrimit të kësaj veprimtarie.
2. Kapitali rregullator i institucionit të pagesave, në çdo kohë, nuk mund të bjerë nën shumën e kapitalit fillestar minimal të përcaktuar sipas kërkesave të parashikuara në rregulloren “Për licencimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, si dhe për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave”, ose nën shumën e kërkesës për kapital rregullator të llogaritur në përputhje me nenin 14 të kësaj rregulloreje, cilado të jetë më e lartë.

3. Në rast se kapitali rregullator i institucionit të pagesave bie nën kufijtë e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, institucioni raporton menjëherë në Bankën e Shqipërisë, e cila përcakton masat e nevojshme dhe kohën për të rivendosur kapitalin brenda kufijve të mësipërm.
4. Në rastin kur institucioni i pagesave jep kredi në lidhje me shërbimet e pagesave, shuma e përgjithshme e kredisë së dhënë, nuk cenon në asnjë rast kapitalin rregullator dhe përmbushjen e kërkesave mbikëqyrëse të Bankës së Shqipërisë.
5. Banka e Shqipërisë, bazuar në vlerësimin e proceseve të administrimit të rrezikut, të dhënave mbi rrezikun e humbjeve dhe të mekanizmave të kontrollit të brendshëm të institucionit të pagesave, mund të kërkojë në çdo rast nivele shtesë kapitali, deri në 20% (njëzet për qind) më të lartë se kërkesa për kapital rregullator e llogaritur sipas përcaktimeve në nenin 14 të kësaj rregulloreje.

Neni 13

Elementet përbërëse të kapitalit rregullator të institucionit të pagesave

1. Institucionet e pagesave llogaritin kapitalin rregullator të tyre si shumë të kapitalit të nivelit të parë dhe kapitalit të nivelit të dytë. Kapitali i nivelit të parë është shuma e kapitalit bazë të nivelit të parë dhe kapitalit shtesë të nivelit të parë.
2. Institucionet e pagesave përfshijnë në llogaritjen e kapitalit rregullator:
 - a) zërat e kapitalit bazë të nivelit të parë të parashikuar në nenin 6 të rregullores “Për kapitalin rregullator të bankës”, pas aplikimit të filtrave prudencialë të parashikuar në nënkreun II të kreut II të asaj rregulloreje, si dhe zbritjeve dhe përjashtimeve kufi të parashikuar në nenin 11, pika 1, shkronjat “a” deri në “i” dhe në nenin 20 të të njëjtës rregullore. Për zbritjet dhe përjashtimet kufi të parashikuara në nenet 11 dhe 20 të rregullores “Për kapitalin rregullator të bankës”, institucionet e pagesave zbatojnë kërkesat e parashikuara në nenet 12-13 dhe 15-20 të asaj rregulloreje;
 - b) zërat e kapitalit shtesë të nivelit të parë të parashikuar në nenin 21 të rregullores “Për kapitalin rregullator të bankës”, pas aplikimit të zbritjeve të parashikuara në nenin 25 të të njëjtës rregullore. Për zërat e kapitalit shtesë të nivelit të parë dhe zbritjet nga kapitali shtesë i nivelit të parë, institucionet e pagesave zbatojnë kërkesat e parashikuara në nenet 22-24 dhe 26-29 të rregullores “Për kapitalin rregullator të bankës”;
 - c) zërat e kapitalit të nivelit të dytë të parashikuar në nenin 30 të rregullores “Për kapitalin rregullator të bankës”, pas aplikimit të zbritjeve të parashikuara në nenin 33 të të njëjtës rregullore. Për zërat e kapitalit të nivelit të dytë dhe zbritjet nga kapitali i nivelit të dytë, institucionet e pagesave zbatojnë kërkesat e parashikuara në nenet 31-32 dhe 34-37 të rregullores “Për kapitalin rregullator të bankës”.
3. Institucionet e pagesave, për qëllime të llogaritjes së kapitalit rregullator, sigurojnë respektimin e kufijve të mëposhtëm:
 - a) të paktën 75% e kapitalit të nivelit të parë është në formën e kapitalit bazë të nivelit të parë; dhe
 - b) kapitali i nivelit të dytë përbën jo më shumë se 33.3% të kapitalit të nivelit të parë.
4. Institucionet e pagesave nuk përfshijnë në llogaritjen e kapitalit rregullator, zërat që janë pjesë e kapitalit rregullator të një subjekti tjetër, i cili është pjesë e të njëjtit grup financiar/bankar ku bën pjesë institucioni i pagesave.
5. Institucioni i pagesave që ushtron edhe veprimtari të tjera tregtare të ndryshme nga ato të ofrimit të shërbimeve të pagesave, siç parashikohen në nenin 19, pika 1, shkronja “c” të ligjit

“Për shërbimet e pagesave”, nuk përfshin ato zëra kapitali që përdoren për veprimtaritë e tjera në llogaritjen e kapitalit rregullator.

NËNKREU II LLOGARITJA E KËRKESËS PËR KAPITAL RREGULLATOR

Neni 14

Metoda e llogaritjes së kërkesës për kapitalin rregullator të institucionit të pagesave

1. Institucioni i pagesave llogarit kërkesën për kapital rregullator, të detyrueshëm për t’u mbajtur në çdo kohë prej tij, sipas rregullave të parashikuara në këtë nen.
2. Kërkesa për kapital rregullator e institucionit të pagesave, llogaritet sipas rregullave të mëposhtme:
 - a) kërkesa për kapital rregullator e institucionit të pagesave duhet të jetë të paktën sa shuma e elementeve të mëposhtme, e shumëzuar me faktorin e përshkallëzuar (*scaling factor*) **k** të përcaktuar në shkronjën “b” të kësaj pike:
 - i. 4,0% e pjesës së VP deri në vlerën ekuivalente në lekë të shumës 5 milion euro; *plus*
 - ii. 2,5% të pjesës së VP mbi vlerën ekuivalente në lekë të shumës 5 milion euro deri në 10 milion euro; *plus*
 - iii. 1% të pjesës së VP mbi vlerën ekuivalente në lekë të shumës 10 milion euro deri në 100 milion euro; *plus*
 - iv. 0,5% të pjesës së VP mbi vlerën ekuivalente në lekë të shumës 100 milion euro deri në 250 milion euro; *plus*
 - v. 0,25% të pjesës së VP mbi vlerën ekuivalente në lekë të shumës 250 milion euro.
 - ku, **VP** është vëllimi i pagesave, i cili përfaqëson 1/12 e shumës totale të transaksioneve të pagesave të ekzekutuara nga institucioni i pagesave në vitin e mëparshëm;
 - b) faktori i përshkallëzuar **k** i parashikuar në shkronjën “a” të kësaj pike është:
 - i. **0,5** kur institucioni i pagesave ofron vetëm shërbimin e pagesave të parashikuar në pikën 6 të aneksit 1 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”;
 - ii. **1** kur institucioni i pagesave ofron shërbimet e pagesave të parashikuara në pikat 1-5 të aneksit 1 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”.
3. Përjashtohen nga kërkesat për kapitalin rregullator të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, institucionet e pagesave që ofrojnë vetëm shërbimet e pagesave sipas pikës 7 ose pikës 8, ose të dyja njëkohësisht, sipas aneksit 1 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”.
4. Në rastin kur institucioni i pagesave në datën e llogaritjes së kërkesës për kapital rregullator nuk ka mbushur një vit të plotë në ushtrimin e aktivitetit të tij, vëllimi i pagesave i parashikuar në pikën 2 të këtij neni, do të llogaritet bazuar në të dhënat e parashikuara në planin e biznesit të paraqitur në procesin e aplikimit për marrjen e licencës, duke reflektuar edhe rishikimet e propozuara nga Banka e Shqipërisë në planin e biznesit (nëse është e aplikueshme).
5. Institucionet e pagesave që japin kredi në përputhje me kërkesat e nenit 19, pikat 4 dhe 6 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, llogarisin një kërkesë për kapital për rrezikun e kredisë, të paktën sa 6% (gjashtë për qind) e tepricës së kredive të disbursuara, duke përjashtuar transaksionet e pagesave të kryera me karta krediti.

6. Institucionet e pagesave mbajnë në çdo kohë një nivel kapitali të paktën sa shuma e kërkesës për kapital për shërbimet e pagesave dhe e kërkesës për kapital për rrezikun e kredisë (aty ku është e zbatueshme).

NËNKREU III MBROJTJA E FONDEVE

Neni 15

Mbrojtja e fondeve të klientëve të institucioneve të pagesave

1. Institucioni i pagesave siguron që fondet e përdoruesve të shërbimeve të pagesave, të mbahen në llogari kontabël të veçanta, të ndara nga llogaritë e tjera të institucionit që nuk lidhen me shërbimet e pagesave.
2. Institucioni i pagesave që ofron shërbimet e pagesave sipas pikave 1 deri në 6 të aneksit 1 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, mbron të gjitha fondet e marra prej përdoruesve të shërbimeve të pagesave ose përmes ofruesve të tjerë të shërbimeve të pagesave, për kryerjen e transaksioneve të pagesave, në përputhje me kërkesat e nenit 12 të ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe në njërin prej formave të parashikuara në shkronjën “a” ose në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 12 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”.
3. Për qëllime të zbatimit të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 12 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, “aktive të sigurta, me rrezik të ulët e likuide” të një institucioni pagesash, do të konsiderohen:
 - a) titujt e borxhit të emetuar ose të garantuar nga qeveria shqiptare, nga qeveritë qendrore dhe bankat qendrore, nga organizatat ndërkombëtare, nga bankat shumëpalëshe të zhvillimit, ose nga qeveritë rajonale ose autoritetet lokale, të cilëve u caktohet shkalla e cilësisë së kredisë “1”, ose që ponderohen me peshën e rrezikut 0%, në përputhje me rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”;
 - b) titujt e borxhit të emetuar ose të garantuar nga qeveria shqiptare, nga qeveritë qendrore dhe bankat qendrore, nga organizatat ndërkombëtare, nga bankat shumëpalëshe të zhvillimit, ose nga qeveritë rajonale ose autoritetet lokale, të cilëve u caktohet shkalla e cilësisë së kredisë “2” ose “3”, në përputhje me rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”;
 - c) titujt e borxhit të emetuar nga institucionet e mbikëqyrura, të cilëve u caktohet shkalla e cilësisë së kredisë “1” ose “2”, ose titujt e borxhit të emetuar nga institucionet e mbikëqyrura, të cilëve u caktohet shkalla e cilësisë së kredisë “3”, por që trajtohen sipas kërkesave të nenit 17/2, pika 3 të rregullores “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”;
 - d) titujt e borxhit të emetuar nga shoqëritë tregtare, të cilëve u caktohet shkalla e cilësisë së kredisë “1” ose “2”, në përputhje me rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”;
 - e) kuotat në sipërmarrjet e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm (SIKTT), të cilat investojnë vetëm në aktivet e përmendura në shkronjat “a” deri në “d” të kësaj pike.
4. Polica e sigurimit ose garancia e parashikuar në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 12 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, duhet të jetë e pagueshme, në rast se institucioni i pagesave nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e tij financiare ndaj përdoruesve të shërbimeve të pagesave, sipas shkaqeve/ngjarjeve (*triggers*) që aktivizojnë zbatimin e tyre dhe të cilat janë të përcaktuara përkatësisht, në kontratën e sigurimit ose në kontratën e garancisë. Polica e

sigurimit ose garancia nuk ka ndonjë klauzolë mbi franshizën, pjesën e zbritshme (*deductible*) ose shumën minimale (*threshold*) që mund të cenojë disbursimin e pagesave të përfituesit ose ndonjë ofrues tjetër i shërbimeve të pagesave.

5. Institucionet e pagesave njoftojnë Bankën e Shqipërisë, para se të ndodhin ndryshime të rëndësishme në masat e marra prej tyre, për mbrojtjen e fondeve të përdoruesve të shërbimeve të pagesave.

Neni 16

Diversifikimi i mbrojtjes së fondeve

1. Institucionet e pagesave që i mbrojnë fondet e përdoruesve të shërbimeve të pagesave, siç parashikohet në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 12 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, investojnë fondet e klientëve në mënyrë të diversifikuar, në kundërparti të ndryshme.
2. Institucioni i pagesave, në vendimmarrjen e tij për format e mbrojtjes së fondeve sipas parashikimeve në nenin 15 të kësaj rregulloreje, mund të marrë në konsideratë edhe elementet e mëposhtme:
 - a) nivelin e kapitalit të bankës dhe/ose shoqërisë së sigurimit, i cili duhet të jetë në proporcion me shumën e fondeve që do të vendosen në llogari ose që do të garantohej apo sigurohet;
 - b) nivelin e ekspozimit ndaj rrezikut që shoqëron aktivitetin e kredithënies apo investimeve të bankës dhe/ose shoqërisë së sigurimit.
3. Institucioni i pagesave dokumenton vendimmarrjen e tij sipas parashikimeve në pikën 2 të këtij neni.

Neni 17

Siguracioni i dëmshpërblimit profesional dhe garancitë e tjera të krahasueshme

Institucionet e pagesave që ofrojnë shërbimet e pagesave sipas pikave 7, 8 ose të dyja (7 dhe 8) të aneksit 1 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, mbajnë një siguracion të dëmshpërblimit profesional ose garanci të tjera të krahasueshme, në përputhje me kërkesat e udhëzimit “Për kriteret për përcaktimin e shumës monetare minimale të siguracionit të dëmshpërblimit profesional ose të garancive të tjera të krahasueshme”.

NËNKREU IV

EKSPOZIMET NDAJ RREZIKUT DHE KUFIZIMET

Neni 18

Normat e lejueshme për pozicionet e hapura valutore

1. Pozicioni i hapur valutë në një valutë të caktuar, përfaqëson shumën ekuivalente në lekë të diferencës midis të drejtave dhe detyrimeve gjithsej të institucionit të pagesave, në këtë valutë.
2. Institucionet e pagesave nuk duhet të tejkalojnë në fund të çdo dite pune, normat e mëposhtme për pozicionet e hapura në valutë:
 - a) raporti i pozicionit të hapur valutë për një monedhë me kapitalin rregullator, nuk duhet të jetë më shumë se 30% (tridhjetë për qind); dhe
 - b) raporti i pozicionit të hapur valutë për të gjitha monedhat me kapitalin rregullator, nuk duhet të jetë më shumë se 40% (dyzetë për qind).

3. Institucionet e pagesave, në llogaritjen e pozicionit të hapur valutor nuk përfshijnë pozicionin strukturor në valutë, i cili është pozicioni që krijohet nga:
 - a) elemente (zëra të bilancit ose jashtë bilancit), të cilat nuk janë të natyrës së veprimtarisë (biznesit) kryesore financiare të subjektit dhe/ose janë elemente të qëndrueshme/afatgjata të tilla si: “interesa pjesëmarrës”; “investimet në filiale”, “aktivet e qëndrueshme të patrupëzuara dhe të trupëzuara” etj.;
 - b) transaksione të institucionit të pagesave, të cilat ruajnë nivelin e kërkesave për kapital rregullator, në rastet kur kjo kërkesë ndikohet nga luhatjet e kursit të këmbimit.

Neni 19

Rreziku i likuiditetit

1. Rreziku i likuiditetit është mundësia e humbjes financiare si rezultat i mungesës së aktiveve likuide të mjaftueshme, për të përmbushur detyrimet kur ato maturohen dhe kërkohen dhe/ose kur institucioni i pagesave nuk ka mundësi të financojë rritjen e aktiveve të veta.
2. Institucionet e pagesave krijojnë sistemin e administrimit të rrezikut të likuiditetit, i cili ka për qëllim administrimin e rrezikut të likuiditetit. Ky sistem përfshin minimalisht strategjinë dhe politikat për administrimin e rrezikut të likuiditetit, strukturën organizative të krijuar për administrimin e rrezikut të likuiditetit, sistemin e kontrollit të brendshëm, sistemin e administrimit të informacionit, etj.
3. Institucionet e pagesave sigurojnë që sistemi i administrimit të rrezikut të likuiditetit, në mënyrë sasiore dhe cilësore, të jetë në përputhje me madhësinë e subjektit, tipologjinë e veprimtarisë së tij dhe nivelin e ekspozimit ndaj rrezikut të likuiditetit.

Neni 20

Dhënia e kredive në lidhje me shërbimet e pagesave

1. Institucionet e pagesave mund të japin kredi në lidhje me shërbimet e pagesave, të parashikuara në pikat 4 ose 5 të aneksit 1 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, siç parashikohet në nenin 19 të atij ligji, nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:
 - a) institucionet e pagesave hartojnë dhe miratojnë rregullore të brendshme, me qëllim administrimin e rrezikut të kredisë, duke parashikuar kërkesa mbi çdo hap të këtij procesi, që përfshijnë analizën paraprake financiare, disbursimin, monitorimin, rishikimin e linjave të kredisë, etj.;
 - b) kredia lehtëson dhe jepet ekskluzivisht me qëllim ekzekutimin e transaksionit të pagesës. Për të siguruar pajtueshmërinë me këtë kusht, institucionet e pagesave miratojnë sisteme dhe procedura për të monitoruar financimin dhe sigurojnë mekanizmat e kontrollit të brendshëm;
 - c) institucionet e pagesave nuk japin kredi nga fondet e marra ose të mbajtura nga përdoruesit e shërbimeve të pagesave, me qëllim ekzekutimin e një transaksioni pagese, të cilat (fondet) i mbrojnë në përputhje me nenin 15 të kësaj rregulloreje, por kredia do të jepet nga fondet e veta të institucionit të pagesave;
 - d) kredia është afatshkurtër dhe duhet të shlyhet brenda një periudhe jo më të gjatë se 12 (dymbëdhjetë) muaj. Përjashtim nga ky rregull mund të bëjë afati i kredisë së dhënë në lidhje me pagesat e bëra me kartë krediti, i cili mund të jetë më shumë se 12 muaj;
 - e) institucionet e pagesave respektojnë kërkesën për kapital rregullator të përcaktuar në nenin 14 të kësaj rregulloreje, që përfshin edhe kërkesat për kapital për rrezikun e kredisë që rrjedh nga këto kredi.

KREU V
KONTABILITETI, AUDITIMI DHE KËRKESAT RAPORTUESE PËR
INSTITUCIONET E PAGESAVE

Neni 21
Kontabiliteti dhe raportet financiare

1. Institucionet e pagesave mbajnë llogaritë kontabël dhe përgatisin raportet financiare për pasqyrimin e gjendjes së tyre financiare, në mënyrë të saktë dhe në përputhje me rregullat e parimet kontabël, mbi baza individuale e të konsoliduara, sipas legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.
2. Kur institucioni i pagesave kryen edhe veprimtari të tjera përveç ofrimit të shërbimeve të pagesave, sipas nenit 19 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, për qëllime të mbikëqyrjes, institucioni mban informacion kontabël të veçantë për këto veprimtari, që duhet të jetë pjesë e raportit të audituesit ligjor.

Neni 22
Auditimi ligjor

1. Llogaritë vjetore dhe llogaritë e konsoliduara të institucioneve të pagesave auditohen nga auditues ligjorë ose shoqëri auditimi, sipas legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare dhe të atij për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar.
2. Detyrimet e përcaktuara në ligjin për bankat dhe në aktin nënligjor përkatës të Bankës së Shqipërisë për ekspertin kontabël të autorizuar të bankave, zbatohen në të njëjtën mënyrë edhe për audituesit ligjorë ose shoqëritë e auditimit të institucioneve të pagesave, lidhur me veprimtarinë e ofrimit të shërbimeve të pagesave.

Neni 23
Raportimi në Bankën e Shqipërisë

1. Institucionet e pagesave raportojnë në Bankën e Shqipërisë sipas kërkesave të përcaktuara në aktet nënligjore për sistemin raportues të unifikuar të këtyre subjekteve.
2. Institucionet e pagesave dërgojnë në Bankën e Shqipërisë, brenda 6-mujorit të parë të vitit pasardhës, një kopje të raportit vjetor dhe të opinionit të ekspertit kontabël të autorizuar, ku pasqyrohet gjendja financiare dhe kontabël, mbi baza individuale dhe të konsoliduara.
3. Institucionet e pagesave raportojnë menjëherë në Bankën e Shqipërisë, për çdo rast të tejkalimit të normave mbikëqyrëse të lejueshme, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje. Banka e Shqipërisë përcakton dhe njofton institucionin e pagesave për kohën dhe masat e nevojshme, me qëllim rivendosjen e treguesve brenda kufijve të lejueshëm.

KREU VI
MBIKËQYRJA, SHKELJET, DHE SANKSIONET

Neni 24
Masat ndëshkimore dhe mbikëqyrëse

Banka e Shqipërisë, në rast mosplotësimi të kërkesave të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse dhe/ose ndëshkimore të parashikuara në nenin 25 dhe në kreun I të Titullit V të ligjit “Për shërbimet e pagesave”.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

Gent SEJKO